



Keshilli i Bashkisë Korçë

Komisioni i Financave, Buxhetit, Pasurive Bashkiake, Planifikimit të Zhvillimit Strategjik të Bashkisë, dhe Mbikqyrjes Financiare

Proçes-verbali i Mbledhjes së Komisionit të Përhershëm të Këshillit

Data e mbledhjes së Komisionit 22/09/2025

Ora e hapjes së mbledhjes 12:00

Marrin pjesë:

1. z. Altin Habip
2. znj. Ada Përmeti
3. z. Petrika Tollkuçi

Marrin pjesë gjithashtu: Këshilltarë / pjestarë të sekretariatit

1. Eva Naci sekretare e këshillit

Nga ekzekutivi marrin pjesë :

1. Valbona Ziko, Denada tabaku, Aida Shkodrani Kristo

Kryesuesi i mbledhjes është Z. Petrika Tollkuçi

Kryetari i Këshillit/ Kryesuesi i mbledhjes **deklaroi kuorumin** prej 3 Këshilltarësh.

Deklarimi i **konfliktit të interesit**: Nuk ka

Pikat e rendit të ditës.

1. **Projekt-vendim (Pika 5 e rendit të ditës) 5-** “*MBI MIRATIMIN E PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESEM 2026-2028, I RISHIKUAR.*” **propozuar nga ekzekutivi.**
2. **Projekt-vendim (pika 6 e rendit të ditës) 6-** “PËR NJË SHITESË NË VENDIM NR.158 DATË 26.11.2024 PËR “NIVELIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE, ADMINISTRIMIN E TYRE NË BASHKINË KORÇË SI DHE PENALITETET PËR SHKELJET APO KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE PËR VITIN 2025.” **propozuar nga ekzekutivi.**
3. **Projekt-vendim (pika 7 e rendit të ditës) 7-** “PËR MIRATIMIN E PJESËMARRJES SË BASHKISË KORÇË NË ZBATIMIN E PROJEKTIT “RISTOR- RURAL INNOVATION CENTERS FOR SUSTAINABLE AND INCLUSIVE TOURISM” NË KUADËR TË PROGRAMIT INTERREG VL-A IPA GREQI- SHQIPËRI 2021-2027 SI DHE MIRATIMIN E FONDEVE SI PJESË E BUXHETIT TË BASHKISË.” **propozuar nga ekzekutivi.**

Drejtuesi i komisionit prezanton projekt-vendimet

U sqaruan nga përfaqësuesit e administratës nevojat për projekt vendimet. U sqarua situata e indeksimit të qerave të banesave sipas legjislacionit në fuqi.

Pyetje : *Për pikën 1, lidhur me rekomandimet e Ministrisë së Financave dhe përgjigjia e Kryetarit të bashkisë ?*

Përgjigje : *Për pagat dhe shpenzimet operative do jetë fondi në rritje për shkak të rritjes së vjetërsisë në punë të punonjësve. Nuk ka të parashikuar rritje page dhe as ndryshim strukture.*

Për pikën 3 *u sqarua pjesëmarrja në projektin Ristore Rural ku përfaqësuesja e Bashkisë sqaroi me detaje se bashkia merr pjesë kryesisht me punonjës dhe pagat e punonjësve aktualë.*

Për pikën 2, *Përgjegjësi i të ardhurave sqaroi propozimin ka erdhur si rezultat i ankesës së personave përfitues tek insitucioni dhe avokati i popullit.*

Mbyllet diskutimi

Përgatitet Vendimi i mbledhjes së Komisionit që do t'i paraqitet këshillit ne seancë.

Vendimi i komisionit u përgatit nga sekretari i Komisionit

Lexohet Projekt-Vendimi i Komisionit nga kryetari

U votua Projekt vendimi sipas pikës 1: PRO 3,

KUNDER 0,

ABSTENIM 0.

Miratohet.

U votua Projekt vendimi sipas pikës 2: PRO 3,

KUNDER 0,

ABSTENIM 0.

Miratohet.

U votua Projekt vendimi sipas pikës 3: PRO 3,

KUNDER 0,

ABSTENIM 0.

Miratohet.

Mbyllet mbledhja e Komisionit

Ora e mbylljes së mbledhjes 13 :00

Nënshkruhet proçesverbali i mbledhjes së komisionit

Kryetari i Komisionit

Sekretari i Komisionit



Keshilli i Bashkisë Korçë

Komisioni i Financave, Buxhetit, Pasurive Bashkiake, Planifikimit të Zhvillimit Strategjik të Bashkisë, dhe Mbikqyrjes Financiare

RAPORT VENDIMMARRJE

Nr.____ datë. 22/09/2025

Nr.____ Prot

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë

Lenda: Vendim për shqyrtimin e projekt vendimeve, relacioneve dhe dokumentave shoqërues të projekt-vendimeve, në lidhje me propozimin

1. **Projekt-vendim (Pika 5 e rendit të ditës) 5-** “MBI MIRATIMIN E PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM 2026-2028, I RISHIKUAR.” propozuar nga ekzekutivi.
2. Projekt-vendim (pika 6 e rendit të ditës) 6- “PËR NJË SHITESË NË VENDIM NR.158 DATË 26.11.2024 PËR “NIVELIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE, ADMINISTRIMIN E TYRE NË BASHKINË KORÇË SI DHE PENALITETET PËR SHKELJET APO KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE PËR VITIN 2025.” **propozuar nga ekzekutivi.**
3. **Projekt-vendim (pika 7 e rendit të ditës) 7-** “PËR MIRATIMIN E PJESËMARRJES SË BASHKISË KORÇË NË ZBATIMIN E PROJEKTIT “RISTOR- RURAL INNOVATION CENTERS FOR SUSTAINABLE AND INCLUSIVE TOURISM” NË KUADËR TË PROGRAMIT INTERREG VL-A IPA GREQI- SHQIPËRI 2021-2027 SI DHE MIRATIMIN E FONDEVE SI PJESË E BUXHETIT TË BASHKISË.” **propozuar nga ekzekutivi.**

Analiza ligjore: (bazueshmëria ligjore e propozimit të projekt-vendimit dhe e vendimit të Komisionit të Përhershëm – a është i mbështetur në ligj propozimi dhe vendimarrja)

Ne zbatim të ligjit nr. 9936 datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, të ligjit nr. 68 datë 27.4.2017 "Për financat e veteqeverisjes vendore", Udhezimit nr. 23 datë 30. 7.2018 "Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njesive të veteqeverisjes vendore", i ndryshuar, udhezimit nr. 19 datë 10.7.2025 "Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2026-2028", si dhe në zbatim të VKB nr. 75 datë 31.7.2025 "Për miratimin e taveve të përfundimtare të shpenzimeve të PBA 2026-2028 në nivel programi", Bashkia Korçë ka përgatitur materialin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2026-2028 (i rishikuar), të cilën e ka dorëzuar në MF brenda afatit të paracaktuar, me nr. Prot., 9234 datë 12.9.2025, Ligjin 139/2015 "Për veteqeverisjen vendore", ligjin 68/2017 "Për financat e veteqeverisjes vendore", ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore", ligjin nr. 43/2016, "Për marrëveshjet ndërkombetare në Republikën e Shqipërisë"; në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 775, datë 24.9.2010 "Për administrimin e financimeve të huaja në Republikën e Shqipërisë"; në VKB nr. 176 datë 26.12.2024 "Mbi miratimin e buxhetit vjetor të vitit 2025 dhe PBA 2025-2027 të Bashkisë Korçë", si dhe në piken 3.3 të Udhezimit nr.10 datë 12.7.2024 "Për regjistrimin, përdorimin, rakordimin, raportimin dhe publikimin e fondeve të financimeve të huaja në kuadrin e marrëveshjeve ndërkombetare"

Situata aktuale e funksionit (përshkrim i situatës së shërbimit / funksionit – nëse konstatohet që ekziston nevoja për këtë vendim të propozuar dhe çfarë problematike zgjidh ai)

Për pikën 1: Hartimi, diskutimi dhe miratimi i PBA-së është detyrim ligjor i legjislacionit si fazë e hartimit të PBA-së përfundimtare dhe dhe buxhetit të vitit 2026.

Për pikën 2: Propozohet përjashtimi nga tarifa e vizitës në kullën panoramike për personat me aftësi ndryshe.

Për pikën 3: Bashkia është fituese e projektit "RISTOR- Rural Innovation centers for Sustainable and inclusive TOurism -RISTOR" ne kuader te programit Interreg VI-A IPA Greqi- Shqiperi 2021-2027 dhe për firmosjen e marrëveshjes kërkohet miratimi i bashkëfinancimit si kusht për realizimin e projektit.

Situata financiare : (Shtesa / pakësime në buxhet – a ka efekte në buxhet dhe a është parashikuar ap nevojitet buxhet shtesë për zbatimin e vendimit)

Pika 1: Projekt vendimi është dokumenta strategjik i cili përcakton vlerat e të ardhurave dhe shpenzimeve për 3 vitet e ardhshme sipas programeve të vetëqeversijes vendore.

Pika 2: Vlera e tarifës së personave me aftësi ndryshe për vizitë në kullën panoramike është e papërfillshme.

Pika 3: Projekti që do zbatohet sjell përfitime të mëdha dhe vlera e financuar është e konsiderueshme, ndërkohë që Bashkia pjesën më të madhe të kontributit e ka në natyrë (staf ne dispozicion ayra etj) dhe vlera e financimit në lek është 1,796,518 lek, vlerë e cila është pjesë e buxhetit të Bashkisë 2026.

Drejtoria / Sektori përgjegjës (kush është sektori apo drejtoria që do të ngarkohet me zbatimin)
Për pikën 1 dhe 2; Kryetari I Bashkisë dhe Drejtoria e Finances dhe të ardhurave. Për pikën 3 Drejtoria e menaxhimit të projekteve me donatorët.

Monitorimi dhe raportimi : (kush monitoron zbatimin, raporton dhe sa shpesh)

Për pikën 1 dhe 2; Kryetari I Bashkisë dhe Drejtoria e Finances dhe të ardhurave. Për pikën 3 Drejtoria e menaxhimit të projekteve me donatorët.

Impakti social / grupet që preken: (a ka efekte sociale, pozitive apo negative, grupet që preken dhe impakti që sjell vendimi)

Pika 1. Planifikim i shpenzimeve për programet buxhetore.

Pika 2: Përfitojnë personat me aftësi ndryshe.

Pika 3: Personat që zhvillojnë aktivitetet turistik, sidomos në zonat rurale.

A është objekt i konsultimit publik: (A është projekt-vendimi subjekt i konsultimit publik në zbatim të Ligjit 139/2015?)

Pika 1: Po. Është shpallur pyetëtori për konsultim publik dhe mendimet dhe sygjerimet do paraqiten për reflektime të mundshme në draftin final të PBA-së 2026-2028.

Pika 2: Jo.

Pika 3: Jo

Komisioni i Përhershëm për “**Komisioni i Financave, Buxhetit, Pasurive Bashkiake, Planifikimit të Zhvillimit Strategjik të Bashkisë, dhe Mbikqyrjes Financiare**”, i mbledhur me datën 23/06/2025, shqyrtoi projekt vendimet, relacionet dhe dokumentat shoqërues në lidhje me propozimet për:

1. Projekt-vendim (Pika 5 e rendit të ditës) 5- “**MBI MIRATIMIN E PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESEM 2026-2028, I RISHIKUAR.**” propozuar nga ekzekutivi.
2. Projekt-vendim (pika 6 e rendit të ditës) 6- “**PËR NJË SHITESË NË VENDIM NR.158 DATË 26.11.2024 PËR “NIVELIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE, ADMINISTRIMIN E TYRE NË BASHKINË KORÇË SI DHE PENALITETET PËR**

SHKELJET APO KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE PËR VITIN 2025.”
propozuar nga ekzekutivi.

3. Projekt-vendim (pika 7 e rendit të ditës) 7- “PËR MIRATIMIN E PJESËMARRJES SË BASHKISË KORÇË NË ZBATIMIN E PROJEKTIT “RISTOR- RURAL INNOVATION CENTERS FOR SUSTAINABLE AND INCLUSIVE TOURISM” NË KUADËR TË PROGRAMIT INTERREG VL-A IPA GREQI- SHQIPËRI 2021-2027 SI DHE MIRATIMIN E FONDEVE SI PJESË E BUXHETIT TË BASHKISË.” propozuar nga ekzekutivi.

Pas shqyrtimit të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese,
Komisioni me shumicë votash,

VENDOSI

- T’i propozojë Këshillit Bashkiak, miratimin e projektakteve.

Argumentat e vendimmarrjes janë paraqitur në proçesverbalin e mbledhjes së Komisionit

Kryetar i Komisionit

Sekretar i Komisionit

Datë 22/09/2025